



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi a) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Ego Elsa shpk" të datës 27.10.2025 në ora 22:24 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Largimi, trajtimi dhe deponimi i materialeve të rrezikshme në Kryeqytet" me nr. të prokurimit 616-25-6217-5-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **HEDHET POSHTË si e pasafatshme** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Ego Elsa shpk" të datës 27.10.2025 në ora 22:24 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Largimi, trajtimi dhe deponimi i materialeve të rrezikshme në Kryeqytet" me nr. të prokurimit 616-25-6217-5-2-1.
- II. **VËRTETOHET** njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** të gjitha palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Ego Elsa shpk" (tutje "parashtruesi") me datë 10.10.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Largimi, trajtimi dhe deponimi i materialeve të rrezikshme në Kryeqytet" me nr. të prokurimit 616-25-6217-5-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur që njoftimi mbi vendimin është publikuar me datë 22.10.2025.

Përmes nenit 60 par. 60.1 nënpar. b) të RRPP është përcaktuar se "Kurdo që kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit brenda afatit prej pesë (5) ditëve pas datës së publikimit të njoftimit mbi vendimin e AK (B58) ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit të projektimit në sistem të prokurimit elektronik. Në kalkulim

të afateve kohore, dita e publikimit të Njoftimit mbi vendimit të AK (B58) është dita (0)". Në rastin konkret dita zero (0) është data 03.10.2025 kur është publikuar njoftimi mbi vendimin. Ndërsa dita e fundit kur ka mundur të parashtrohen kërkesat për rishqyrtim është data 27.10.2025 deri në ora 16:00. Mirëpo parashtruesi e ka dorëzuar kërkesën e tij për rishqyrtim me datë 27.10.2025 në ora 22.24 që kalkulohet sikurse të jetë dorëzuar me datë 28.10.2025 në kuptim të nenit 5 të LPP. Rrjedhimisht kërkesa është dorëzuar pas afatit ligjor. Në këtë mënyrë është gjetur se kërkesa për rishqyrtim është jashtë afatit dhe duhet të hedhet poshtë si e tillë.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se kërkesa për rishqyrtim është paraqitur pas afatit të përcaktuar me nenin 60 paragrafin 60.1 paragrafin b) të RRPP dhe si e tillë ajo duhet të refuzohet si palejuar përkatësisht si e pasafatshme në kuptim të nenit 62.1. paragrafit a) lidhur me nenin 63 paragrafit 63.1 nënparagrafit 63.1.1 pikës b) të RRPP.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1 nënparagrafin 63.1.1 pikën b) lidhur me nenin 62 paragrafin 62.1 nënparagrafin b) si dhe nenin 60 paragrafin 60.1. nënparagrafin a) të RRPP. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 03.11.2024

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.